



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 317/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes fushatë në ditën e zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.317/2019 e datës 06.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka paraqitur në PZAP, ankesën Anr.317/2019, me të cilën pretendon se Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka kryer shkelje të nenit 36 par.1 pika b) të LPZ-së, dhe nenin 8 pika b) të rregullës 13/2013 të KQZ-së. Si dëshmi për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur një fotografi në cilësi të provës materiale

Në përgjigje në ankesë të datës 07.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), deklaroi se nga ana e subjektit tonë nuk janë shkelur rregullat zgjedhore dhe Kodi i Mirësjelljes së Partive Politike, për arsye se në bazë të ankesës nuk dihet data se kur është bërë fotoja, ajo mund të jetë bërë më herët, dhe të përdoret gjatë ditës së zgjedhjeve.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës, vlerësimi të pretendimeve ankimore, dhe provës materiale – fotografisë së bashkangjitur, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj datën dhe orën e

bërjes së fotos siç është cekur në ankesë, dhe po ashtu nga prova e bashkangjitur në shkresat e lëndës, paneli nuk mundi të vërtetoj se kush është autori i fotos në fjalë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, rregullave të KQZ-së dhe Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.317/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*